



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:189327
Datë: 13.06.2024
Numri i dokumentit: 05839873

Ac.nr.3717/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dardan Kadolli, kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Hunaida Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Q. B., adresa: Prishtinë, përfaqësuar nga A. I., avokat në Prishtinë, rr. “B. K.”, blloku ../., nr..., kundër të paditurës K. e S. “E.” me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga A. K., objekti i kontestit kompensim i dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.3028/15, i datës 02.12.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditues K. e S. “E.” me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.3028/15, datë 02.12.2019, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr.3028/15, i datës 02.12.2019, ka vendosur si në vijim: **APROVOHET** në tërësi e bazuar kërkespadija e paditesit Q. B. nga Prishtina, Detyrohet e paditura K. e S. “E.” në Prishtinë, që paditesit në emër te kompensimit të dëmit material për automjetet nga auto pergegjesia, për aksidentin e datës 29.07.2015, t’i paguaj shumën prej 1464.00 Euro, me kamat vjetore në lartësi prej 8%, duke filluar nga data 02.12.2019 dita kur eshte nxjerrurr aktgjykimi e deri ne pagesen përfundimtare si dhe shpenzimet e procedures ne lartesi prej 524.00 euro, e te gjitha ne afat prej 15 ditesh nga marrja e aktgjykimit e nën kërcenim të permbarimit ligjore.

Kundër këtij aktgjykimi paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë dhe atë për zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Sipas pretendimeve ankimore, ekspertiza e makinerisë ka të meta, ngase ka llogaritur çmimin pjesëve për zëvendësim duke mos i marrë parasysh amortizimin e automjetit i cili në kohën aksidentit ishte i vjetër, po ashtu ksoerti është bazuar në pro faturën e Porche Kosova.

Në shkresa të lëndës nuk mund të gjendet se pala paditëse ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e të paditurit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se pala paditëse përmes të autorizuarit të tij me datë 11.12.2015 ka paraqitur padi për kompensimin e dëmit, të shkaktuar lidhur me aksidentin e datës 29.07.2015, kundër të paditurës për shkak se është shkaktuar fatkeqësi e komunikacionit në të cilën dëme të konsiderueshëm material në automjetin e tij të udhëtarëve V... T. ka pësuar paditësi Q. B.. Paditësi kërkoj nga e paditura në procedure jashtëgjyqësore kompensimin e dëmit, mirëpo e paditura i ofroi një shume me te cilën paditësi nuk është pajtuar. Kjo meqenëse automjeti është mjaft i ri, i prodhuar ne vitin 2010, dhe pjesët e dëmtuara konsiderojmë se duhet të vendosen te reja e jo te përdorura, ashtu siç ka vepruar tani paditësi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave, si dhe vlerësimit të tyre, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, duke aprovuar kërkesëpadinë e paditësit.

Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka dhënë vlerësimin se duke qenë se nuk është kontestuar baza juridike e kërkesëpadisë nga ana e të paditurës, e bën atë përgjegjëse për kompensimin e dëmit, pasi shkaktuesi i dëmit ka të lidhur kontratë me të paditurën dhe mbi këto rrethana kompensimi bëhet mbi bazën e sigurimit të detyrueshëm nga auto përgjegjësia. Në këtë çështje juridike kontestuese ishte vetëm lartësia e kërkesëpadisë, për këtë rrethanë, gjykata ka administruar ekspertizën e makinerisë të punuar nga eksperti Q. A., sipas së cilës ka rezultuar se vlera e dëmit të automjetit të dëmtuar është në shumë prej 1464.00€. Gjykata ka vlerësuar ekspertizën si të punuar mirë dhe të njëjtës ia ka falur besimin, prandaj ka vendosur të aprovoj kërkesëpadinë në këtë lartësi.

Gjykata e Apelit e Kosovës nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k), dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Nuk kishte pretendim ankimor specifik për sa i përket shkeljeve të dispozitave procedurale, prandaj gjykata e shkallës së dytë kufizohet në vetëm ato që kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Apelit nuk është lëshua në analizë më të zgjeruar sa i përket bazës juridike të kërkesëpadisë, për ndërgjyqësit nuk ishte kontestuese përgjegjësia në ngjarjen e shkaktuar, pra për këtë janë pajtuar, gjithashtu nuk kishte pretendim ankimor për këtë pjesë.

Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Si rrjedhojë e vërtetimit të gjendjes faktike dhe peshimit të duhur të fakteve dhe provave, gjykata ka arritur që gjendjen faktike të kualifikoj drejtë në normat materiale të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Neni 136 i LMD-së rregullon *Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*. Në rastin kontestues dëmi është i shkaktuar nga baza e autopërgjegjësisë. Kurse neni 137 i LMD-së thotë: *Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur)[...]*. Prandaj gjykata duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, duke i vlerësuar të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit material, me të drejtë ka miratuar kërkesëpadinë e paditësit të bazuar në vlerën e shpërblimit të dëmit.

Pretendimet ankimore të palës së paditur për sa i përket fakteve të ngritura se shuma e kompensimit që është njohur nga gjykata e shkallës së parë, nuk është e drejtë, ngase eksperti ka llogaritur çmimin e pjesëve për zëvendësim duke mos marrë parasysh amortizimin e automjetit i cili i cili ishte i vjetër, gjykata e i gjen të njëjtat të pa bazuara. Së pari në seancë të shqyrtimit kryesor, nuk kishe ndonjë kërkesë të palës së paditur për sqarime nga eksperti i makinerisë, apo vërejtje substanciale që do të determinonte nxjerrjen e një ekspertize të re. Gjithashtu nga analizimi i ekspertizës vërtetohet se eksperti është bazuar në pjesët e dëmtuara të veturës dhe nevojës për ndërrimin e tyre, në mënyrë që të rivendoset gjendja e veturës për qarkullim. Prandaj pretendimi i të paditurës është i pa bazë.

Gjykata e shkallës së parë për shumën e gjykuar ka caktuar kamatën e cila fillon të rrjedh nga data e nxjerrjes së aktgjykimit në shkallë të parë, datë 02.12.2019. Duke qenë se nuk pati ankesë nga pala paditëse, kjo pjesë mbeti siç është gjykuar nga gjykata e shkallës së parë.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykata e Apelit në bazë të nenit nenin 194 dhe 195 par. 1 pika d) lidhur me nenin 200 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
Ac.nr.3717/2021, datë 13.06.2024

Kryetari i Kolegjit, Gjyqtari
Dardan Kadolli